



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2021:068126  
Datë: 04.11.2024  
Numri i dokumentit: 06395383

**C.nr.582/2021**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN Departamenti i Përgjithshëm,** me gjyqtarën Edije Sezairi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Z.K. nga Prizreni, të cilën me autorizim i përfaqëson i autorizuari avokat V.O. nga Prizreni, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Dukagjini”, me seli në Prishtinë, për shkak të kompenzimit të dëmit, jashtë seance të datës 04.11.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**  
**Në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia**

**I. REFUZOHET si e pabazuar** kërkesëpadia e paditësit Z.K. nga Prizreni,, me të cilën kanë kërkuar që të obligohet i padituri Kompania e Sigurimeve “Dukagjini”, me seli në Prishtinë, që të kompensoj demin, si dhe të detyrohet i padituri që ti paguajë shpenzimet procedurale.

**II.** Shpenzimet procedurale bien në barrë të paditësit.

**A r s y e t i m**

Paditësit Z.K. nga Prizreni, të cilën me autorizim i përfaqëson i autorizuari avokat V.O. nga Prizreni, ka parashtruar padinë kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Dukagjini”, me seli në Prishtinë, për shkak të kompenzimit i dëmit.

I autorizuari i paditësit avokat V.O. nga Prizreni me parashtrësën të dorëzuar në gjykatë me datën 01.11.2024 ka cekur se në kuptim të dispozitës së nenit 149, par. 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, hek dorë nga kërkesëpadia, pasi që i padituri e ka përmbushur detyrimin e tij ndaj paditësit në tërësi.

Në lidhje me shpenzimet procedurale gjykata vendosi që të njëjtat të bien në barrë të palës paditëse.

Numri i lëndës: 2021:068126

Datë: 04.11.2024

Numri i dokumentit: 06395383

Andaj, gjykata bazuar në nenin 149.1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), pa shqyrtim të mëtejshëm, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet ligjore për një gjë të tillë.

**GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN**

**Departamenti i Përgjithshëm**

**C.nr.582/2021 datë 04.11.2024**

**Gj y q t a r j a**

**Edije Sezairi**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.